



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), nenit 24 dhe nenit 25 të Rregullores QRK, nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, mori këtë:

## V E N D I M

### PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Prishtinë.
- II. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: Parcela kadastrale e identifikuar me certifikatë të pronësisë nr. P-71914059-02735-1, me sipërfaqe prej 26164 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore (FSHMN) dhe Fakulteti Ekonomik.
- IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë, në periudhën për 99 vjet.
- V. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.
- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.

**IX.** Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:

- Kërkesa,
- Certifikata e njësisë kadastrale,
- Kopja e planit për parcelën kadastrale nr.2735-1, Zona kadastrale Prishtinë.

**X.** Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-463/01-257616/22, më 25.11.2022

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina



## ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, gjegjësisht Rektori i UP-së në Prishtinë, me shkresën zyrtare nr.13-353/01-234000/22, dt. 25.10.2022, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës, shfrytëzimin e pronës komunale, për parcelën kadastrale: nr.2735-1, sipërfaqe prej 26164m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës.

Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është në afat për 99 vjet. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës, do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore si në pjesën hyrëse të këtij Vendimi dhe në shkresat e lëndës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.